



BASHKIA E TIRANËS

URDHËRESË

Nr. 25850 Dt. 26.09 2016

Për

“Rregullat dhe kushtet e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës”

Me qëllim përdorim të uniformuar të hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës dhe krijimin e një mjedis urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit, si dhe në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronjat “a” e “b”, nenit 23, pika 14 dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 4/1, të Ligjit nr. 107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar); nenit 8, të Ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, për “Organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës” (i ndryshuar); nenet 10, 11, 15 dhe 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1096 datë 28.12.2015 për “Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; Vendimin Nr. 37, datë 03.09.2015 për “Gjobat për dëmtime në rrjetin rrugor, rrjetin elektrik rrugor dhe hapësirat e gjelbra të Bashkisë Tiranë dhe metoda e vlerësimit të dëmit”; Pikën II.b të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59 datë 30.12.2015 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Tiranës” (i ndryshuar), me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullave dhe kushteve për zënien e hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës” sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe publikimin e menjëhershëm të saj në faqen zyrtare internet të Bashkisë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik të hartojnë dhe t’i paraqesin për miratim Kryetarit formularët e aplikimit/lejimit për çdo kategori aktiviteti të lejuar, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj urdhërese.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Planifikimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të marrin masa për trajnimin e strukturave inspektuese në lidhje me njohjen dhe zbatimin e kësaj urdhërese, i cili duhet të ketë përfunduar brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj urdhërese.
4. Subjektet që ushtrojnë aktivitet në hapësirat publike nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës, të pajisen me lejen përkatëse brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj urdhërese.

5. Ngarkohet Qendra e Regjistrimit dhe Licencimit të fillojë marrjen dhe shqyrtimin e aplikimeve nga subjektet e interesuara pas 60 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj urdhërese.
6. Për zbatimin e kësaj urdhërese ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Policia Bashkiake, Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit – Bashkia Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatime dhe Taksave Vendore.
7. Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion Veliaj

